



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË  
DREJTAT E NJERIUT

Tiranë, më 27.1.2025

(Dokument parlamentar)

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PROJEKTLIGJ

“PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.29/2023, “PËR TATIMIN MBI TË  
ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR”

➤ *Hyrje*

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit **për dhënie mendimi** bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 27.1.2025, mori në shqyrtim projektligjin “Për një shtesë në Ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, i propozuar nga Deputeti, z. Blendi Klosi.

Komisionin caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin z. Denis Deliu.

Në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar, diskutuar dhe paraqitur propozime për projektligjin ishin të pranishëm ;

1. z. Blendi Klosi - Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë
2. znj.Arjana Dyrmishi - Drejtore e Përgjithshme e Politikave Tatimore në Ministrinë e Financës
3. Zarina Taja – Drejtore e Tatimeve Direkte në Ministrinë e Financës

➤ *Baza kushtetuese e projektligjit*

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, vjen si një nisëm deputetit Blendi Klosi, e cila paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 81 pika 1, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit

➤ ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

○ *Qëllimi i projektligjit*

Qëllimi i projektligjit është të përjashtojë nga tatimi mbi të ardhurat e korporatës entitetet që operojnë në struktura akomoduese “hotel/resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruara dhe njohur ndërkombtarisht “brand name”, përjashtojë nga tatimi mbi të ardhurat e korporative për një periudhë 10 -vjeçare, për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2026.

Efektet e përjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit.

Ky projektligji synon incentivimin e sektorit të turizmit duke ulur normën tatimore në 0% për 10 vitet e para fiskale, për strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit

Synimet e projektligjit janë:

- ✓ nxitjen dhe tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja.
- ✓ përmirësimi dhe rritja e standarteve dhe cilësia e industrisë së turizmit.
- ✓ rritjen e konkueshmërisë duke e bërë Shqipërinë më tërheqëse për investitorët dhe turistët.
- ✓ promovimin e një modeli të qëndrueshëm dhe elitare të turizmit.
- ✓ krijimi i vendeve të reja të punës dhe fuqizimi i ekonomisë lokale.

Pra, ky projektligj synon të zhvillojë turizmin duke ofruar lehtësi fiskale për hotelet dhe resortet me katër dhe pesë yje, me status special dhe marka ndërkombëtare. Qëllimi është të tërhiqen investime, të rritet cilësia e shërbimeve dhe të forcohet imazhi i Shqipërisë si destinacion elitare, duke krijuar më shumë vende pune dhe gjallëruar ekonominë lokale.

○ *Përmbajtja e projektligjit:*

Projektligji, “Për një shtesë në Ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, parashikon që pas shkronjës “e” të pikës 1, të nenit 27 të shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) entitetet që operojnë në struktura akomoduese “hotel/resort me katër dhe pesë yje, status special” sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruara dhe njohur ndërkombtarisht “brand name”, përjashtojë nga

tatimi mbi të ardhurat korporative për një periudhë 10 -vjeçare, për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2026. Efektet e përjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit”

➤ *Vlerësimi i shkallës së përafrimit me Acquis Communautaire*

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë acquis të BE-së.

➤ *Efektet Financiar*

Projektligji nuk shprehet për efektet financiare.

➤ *Shqyrtimi i projektligjit në komision:*

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut mori në shqyrtim edhe mendimin e Këshillit të Ministrave për projektligjin joqeveritar “Për një shtesë në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar “, propozuar nga deputeti z. Blendi Klosi.

Gjatë prezantimit të hollësishëm të projektligjit, z. Klosi u shprehur se ky projektligj ka për qëllim të stimulojë zhvillimin e turizmit në Shqipëri duke ofruar uljen e normës tatimore në 0% një periudhë 10-vjeçare përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat për struktura akomoduese të kategorisë "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", të cilat janë të njohura ndërkombëtarisht dhe mbajnë një markë tregtare të regjistruar.

Ky projektligj synon të inkurajojë investimet e huaja në këtë sektor dhe të përmirësojë cilësinë e akomodimeve, duke e bërë Shqipërinë një destinacion më konkurrues.

Pra përmes këtij propozimi, synohet,

- tërheqja e investimeve të huaja në sektorin e turizmit, duke rritur nivelin e cilësisë së strukturave akomoduese,
- zhvillimi i një infrastrukture më të gjerë dhe më cilësore, që mund të ofrohet vetëm nga grupet hoteliere me përvojë.
- Krijimi i mundësive të reja për punësim dhe rritja e numrit të turistëve, duke kontribuar në rritjen e konsumit dhe GDP-së.

Me tej z. Klosi theksoi se ky projektligj përfaqëson një mundësi të rëndësishme për të rritur konkurrueshmërinë e turizmit shqiptar dhe për të përmirësuar imazhin e vendit, duke ofruar përfitime të mëdha për ekonominë në përgjithësi.

Ne fjalën e tij z. Klosi u shpreh se është dakord me propozimin e Këshillit të Ministrave për zgjatjen e afatit maksimal për nisjen e zbatimit të përjashtimit nga 3 në 5 vjet, pasi ky propozim bazohet në problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kuadrit ligjor për investitorët me status

special, ku periudha për aplikimin dhe zbardhjen e lejes së ndërtimit shpesh ka tejkaluar afatin ekzistues dhe për më tepër, projektet me përmasa të mëdha kanë kërkuar kohë realizimi më të gjatë se 3 vjet, duke penguar përfitimin e lehtësirave fiskale.

Për më tepër, ky propozim synohet të sigurohet efektiviteti i statusit special, duke u ofruar investitorëve një periudhë më realiste për përmbushjen e kushteve dhe realizimin e investimeve, ndërkohë që ruhet qëllimi i ligjit për të nxitur dhe mbështetur zhvillimin ekonomik.

Deputeti z. Denis Deliu, në cilësinë e relatorit vlerësoi rëndësinë e nismës për zhvillimin e sektorit të turizmit, rritjen e numrit të të punësuarve, por dhe standardeve të turizmit, si dhe u dakortësua me propozimin e Këshillit të Ministrave që *“efektet e përjashtimit të fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 5 vjet nga marrja e statusit special.”*

Z. Deliu ftoi kolegët për të miratuar projektligjin sipas Vendimit nr. 401, datë 5.7.2023 të Këshillit të Ministrave.

### ➤ **Përfundime**

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se:

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit; dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi atë dhe u shpreh dakord për t’ia përcjellë mendimin Komisionit Përgjegjës dhe për votim në seancë plenare.

**RELATOR**

**Denis DELIU**

**KRYETAR**

**Klotilda BUSHKA**